



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.270/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Vedat Poterqoi – Kryetar, znj. Kimete Gashi – Referuese znj. Nita Bejta – Anëtare, znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani – Anëtare, dhe z. Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Rojet e Nderit”SH.P.K.– Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Delta Security”-Prishtinë, Lot I dhe OE: “Security Code” – Prishtinë Lot II, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të QKMF dhe QMU-së Lot I dhe Lot II”, me nr. të prok: 616-22-6436-2-1-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Prishtinë”, më datën: 09.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Hudhet si e palejuar**, ankesa e operatorit ekonomik: “Rojet e Nderit”SH.P.K.– Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të QKMF dhe QMU-së Lot I dhe Lot II”, me nr. prok 616-22-6436-2-1-5, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna Prishtinë.
- II.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- III.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave

ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

- IV. Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 109 dhe 108/A paragrafi 2 të LPP-së, operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.
- V. Obligohet, Operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6-të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Rojet e Nderit”SH.P.K.– Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 15.07.2022 me nr. 270/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të QKMF dhe QMU-së Lot I dhe Lot II”, me nr. të prok: 616-22-6436-2-1-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Prishtinë.

Paneli shqyrtues me rastin e tërheqjes për vendosje të lëndës, gjatë mbajtjes së seancës për këshillim-votim me datë 09.09.2022, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit teknik të prokurimit, dhe të gjithë parashtruesat e palëve në procedure, ka konstatuar se ankesa e dorëzuar nga Operatori Ekonomik Ankues është e palejuar dhe nuk do të ishte dashur që

të pranohej fare për shqyrtim nga OSHP, sipas nenit 109, paragrafi 1 dhe 2, si dhe në nenin 108/A, paragrafi 6, të LPP-së.

Paneli shqyrtues ka konkluduar se me këtë rast nuk janë respektuar afatet kohore për parashtrim të ankesave konform legjislacionit në fuqi.

Duke u nisur nga fakti se dispozitat ligjore të LPP-së konkretisht neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve paragrafi 3 dhe nën paragrafi 6 përcakton se:

6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Ndërsa, paragrafi 1 i Nenit 109 përcakton:

“Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.”

Si dhe paragrafi 2 I nenit 109, I cili citon:

“Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.”

Lidhur me rastin konkret, vlen të sqarohet që:

Operatori ekonomik kërkesën për rishqyrtim e ka bërë me datë 15.07.2022 lidhur me këtë aktivitet prokurimi, ky informacion është marrë tek portali i e-prokurimi. Kalkulimi i afateve për shqyrtimin e kësaj kërkesë duke u bazuar në dispozitat e lartcekura qëndron si në vijim:

Kërkesa për rishqyrtim është bërë me datë 15.07.2022 (e premte), nëse llogariten 3 ditë pune del që kjo ka kërkesë ka pasur afat shqyrtimi 3 ditë, që përlllogaritet si në vijim:

18.07 (e Hënë), 19.07 (e Martë) si dhe 20.07 (e Mërkurë), ky afat përveç të tjerash mund edhe të zgjatet në raste specifike, nëse nuk zgjatet, në rastin tonë i bie që vendimin e Autoritetit Kontraktues për kërkesën për rishqyrtim është dashur që të pritët nga Operatori Ankues të paktën deri me datë 20.07, ora 16:00.

Ndërsa OE ankues Rojet e Nderit”SH.P.K, ka parashtruar ankesën ne OSHP me datë **15.07.2022**, e cila është protokolluar me datë **15.07.2022**, **duke mos pritur** udhëheqjen e një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Bazuar në faktet e mësipërme, Paneli Shqyrtues konsideron se në këtë rast nuk janë respektuar afatet kohore të rregulluara me ligj, andaj kjo ankesë hedhet poshtë si e palejuar.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “KK- Prishtinë ”,

1x1 OE - “Rojet e Nderit”SH.P.K.– Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.